



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-003

Prishtinë, më 28 shtator 2017, në orën 21:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 28 SHTATOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Kujtim Shala dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit: Blerand Stavileci dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Nga EUSR: Blerta Bejtullahu.

Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen në fillim e kryesoi Xhavit Haltit, nënkryetar i Kuvendit, ndërsa më vonë Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryesuesit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rendi i ditës

1. Propozim-vendimi për formimin e komisioneve parlamentare,
2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme,
3. Përgatitjet për seancën e re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave,
5. Të ndryshme.

* * *

1. Propozim-vendimi për formimin e komisioneve parlamentare

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Kryesia në mbledhjen e kaluar ka vendosur që seancës plenare t'ia propozohet formimi i 14 komisioneve parlamentare në Legjislaturën VI.

Gjithashtu, është bërë edhe ndarja e komisioneve parlamentare ndërmjet grupeve parlamentare, pozita e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të parë, ndërsa për pozitën e zëvendëskryetarit të dytë ka mbetur që grupet parlamentare të deputetëve që nuk janë shumicë t'i harmonizojnë qëndrimet ndërmjet tyre. Ndërsa për numrin e anëtarëve në komisioneve parlamentare, me 9 anëtarë apo me 11 anëtarë, do të vendoset sot në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare. Nëse vendosim për 11 anëtarë, duhet të kërkohet nga GP i LVV që ta propozojë edhe nga një (1) anëtar në 9 komisione. Ndërsa nëse vendosim me 9 anëtarë, atëherë duhet të kërkohet nga GP PDK që ta heqë nga një anëtar në 9 komisione parlamentare.

Kryesuesi e hapi diskutimin.

Lidhur me Propozim-vendimin për formimin e komisioneve parlamentare diskutuan: Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Bilall Sherifi, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Kujtim Shala, Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pati qëndrime të ndryshme për numrin e anëtarëve në komisionet parlamentare. Kryesuesi e hodhi në votim propozimin që edhe në 9 komisione parlamentare të jenë nga 11 anëtarë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 3,
Kundër ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kryesia e Kuvendit me shumicë votash vendosi që Kuvendit t'ia procedojë Propozim-vendimin për formimin e komisioneve parlamentare me nga 11 anëtarë

për të gjitha komisionet, me përjashtim të Komisionet për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, i cili duhet t'i ketë 12 anëtarë (neni 78 i Kushtetues).

Në vazhdim, mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kjo pikë ka qenë në rend dite edhe në mbledhjen e kaluar të Kryesisë, por propozimi i nënkryetarit të Kuvendit z. Kujtim Shala, nuk është përkrahur nga shumica e nënkryetarëve të Kuvendit.

Ndërkohë, Qeveria e ka proceduar Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, i cili u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari e hapi diskutimet për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, të filluar më 10 shtator 2017.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë pikë, njëzëri vendosi që seanca e jashtëzakonshme t'i vazhdojë punimet të hënën, më 2 tetor 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar për Parimet programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2017-2021.

3. Përgatitjet për seancën e re plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit për përgatitjet dhe plotësimin e kushteve të pikave që do të shqyrtohen në seancën e radhës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, njëzëri vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të martën, më 3 tetor 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare,
5. Interpelanca e Kryeministrit, Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të LDK-së për ta informuar Kuvendin mbi akuzat publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo.

4. Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në takimin që kishte pasur me shefen e Zyrës së BE-së ishte diskutuar për nevojën e miratimit të Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Ai propozoi që kjo marrëveshje të ratifikohet në fillim të javës së ardhshme, 3-4 tetor 2017.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të martën, më 3 tetor 2017, pasi të përfundojë seanca paraprake, me këtë:

Rend dite

1. Ratifikimi i Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

5.1. Shqyrtimi i kërkesave të ish-deputetëve për pagën kalimtare

Kryetari i njoftoi të pranishmit se disa ish-deputetët të Legjislaturës V kanë parashtruar kërkesë për realizimin e pagës kalimtare. Ndalesa e pagës kalimtare të deputetit është bërë sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, më 15 maj 2017, i cili është nxjerr në bazë të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe Rregullores së Kuvendit.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Ish-deputetit, i cili nuk është rizgjedhur deputet në Legjislaturën VI të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deklaroi me shkrim se nuk ka të hyra financiare nga ndonjë burim tjetër, me përjashtim të Trustit Pensional, i lejohet pagesa e pagës kalimtare e deputetit, dhe këtë të drejtë mund ta shfrytëzojë deri më 10 maj 2018.

2. E drejta në pagën kalimtare të deputetit ndërpritet nëse në ndërkohë punësohet në ndonjë institucion.

5.2. Organizimi i Programit hyrës për deputetët e rinj të Legjislaturës VI

Kryetari i njoftoi të pranishmit për përgatitjet e Programi hyrës për deputetët e rinj që mbështetet nga NDI-ja dhe do të realizohet në kuadër të grupeve parlamentare. Ai kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare që të koordinohen me NDI-në për realizimin e këtij programi.

5.3. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ “Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. OJQ “Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës mbështetet financiarisht në shumën prej 2 600€.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare me nr.1401000000912464, Banka Ekonomike.

5.4. Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të GP “6+”, Albert Kinolli për lejimin e shfrytëzimit të zyrës S-12

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, vendosi që kryetarit të GP “6+”-it t’i ndahet zyra S-12.

6. Të ndryshme

6.1. Emërimi i anëtarëve në Forumin për Transparencë Parlamentare

Kryetari i njoftoi të pranishmit për aktivitetet e Forumin për Transparencë Parlamentare për ta rritur transparencën parlamentare gjatë Legjislaturës së mëparshme. Ai shtoi se ky forum duhet të vazhdojë me aktivitetin e vet edhe në Legjislaturën VI. Për ta funksionalizuar punën e forumit, kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Forumin për Transparencë Parlamentare.

6.2 Kërkesa e kryetarit të Kuvendit për shtimin e numri të këshilltarëve

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kabinetit të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës i shtohet stafi edhe për tre (3) këshilltarë.

6.3 Propozimi i nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, për mbajtjen e Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Prishtinë

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i njoftoi të pranishmit për aktivitetin e tij që Asambleja Parlamentare e NATO-s në vitin e ardhshëm të mbahet në Prishtinë.

Kryesia, pasi diskutoi për propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e mbështet propozimin që Asambleja Parlamentare e NATO-s të mbahet në qershor të vitit 2018, në Prishtinë.
2. Shpenzimet lidhur me organizimin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s do të mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 22:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale